

## Vendim nr. 101 datë 10.05.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Genti Ibrahimimi,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 10.05.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 8 (A) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** ALBAN RULI

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-1729, datë 31.10.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i lidhur me rekursin ndaj vendimit nr. (30-2023-4123) 1109, datë 18.07.2023 të Gjykatës së Apelit së Juridiksionit të Përgjithshëm, i lidhur me ankimin ndaj vendimit datë 29.06.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i shkeljes/privimit të lirisë dhe caktimi i masës së sigurimit personal në mënyrë të përshtatshme, proporcionale, objektivist të mbështetur në fakte, prova dhe ligj, sipas nevojave dhe ngushtësisht lidhur me vetë procedimin penal nr. 8586/2022, në përputhje me parashikimet detyruese të Kushtetutës, Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Kodit të Procedurës Penale, vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, vendimeve unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së

Lartë, vendimeve të Kolegjeve Penale të Gjykatës së Lartë, në respektim të të drejtave të patjetërsueshme themelore të njeriut, në përputhje me legjislacionin penal në fuqi dhe procedurën penale të konsoliduar ndër vite.

Dërgimi i çështjes për rigjykim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, me një trup tjetër gjykues.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 4, 15, 17, 18, 30, 33, 42, 43, 44, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, 141 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 5, 6, 8, 13 dhe 34 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); neni 2 i Protokollit nr. 1 të saj; Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike; nenet 27, 49, 50, 71, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. 8586, datë 25.11.2022 (*procedimi penal nr. 8586/2022*) për veprat penale “Vjedhja”, “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës”, të parashikuara nga nenet 134, paragrafi i tretë, 248 dhe 320 të Kodit Penal (*KP*).

2. Në datën 05.01.2023 ajo prokurori ka urdhëruar regjistrimin e emrit të kërkuesit së bashku me dy persona të tjerë si të dyshuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 248 i KP-së. Sipas prokurorisë, ka dyshime se veprimet e kryera nga kërkuesi si përmbarues privat,

përfaqësues i Zyrës Përmbartimore “ARB”, së bashku me persona të tjerë, i kanë sjellë dëm buxhetit të shtetit. Bazuar në tërësinë e provave të marra në fazën e hetimeve paraprake, prokuroria ka kërkuar që për kërkuesin të caktohej masa e sigurimit personal “Arresti në burg”, e parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale (KPP). Kërkesa është pranuar nga gjykata me vendimin e datës 11.01.2023. Gjithashtu, mbështetur në kërkesën e prokurorisë për marrjen në pyetje të kërkuesit dhe vazhdimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”, gjykata, me vendimin e datës 13.01.2023, ka vendosur vazhdimin e masës së sigurimit. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

3. Gjkata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 9, datë 02.02.2023, ka vendosur ndryshimin e vendimit të datës 13.01.2023 dhe caktimin e masës së sigurimit personal “Arresti në shtëpi”, të parashikuar nga neni 237 i KPP-së, me arsyetimin se nuk plotësohen kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të parashikuara nga nenet 229 dhe 230 të KPP-së dhe se ajo do të ishte më e përshtatshme dhe në përputhje me nevojat e sigurimit, duke mbajtur në konsideratë edhe qëndrimet dhe orientimet e dhëna në vendimin unifikues nr. 7, datë 14.10.2011 (*vendimi unifikues nr. 7/2011*) dhe nr. 1, datë 08.01.2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

4. Në datën 21.06.2023 prokurori ka vendosur zgjatjen e afateve të hetimeve për tre muaj, nga data 21.06.2023 deri në datën 21.09.2023, për shkak të nevojës për kryerjen e veprimeve të tjera hetimore dhe njoftimin e akteve procedurale personave nën hetim.

5. Kërkuesi në datën 30.05.2023 ka paraqitur kërkesë për revokimin e masës së sigurimit “Arresti në shtëpi”, e cila është rrëzuar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me vendimin e datës 29.06.2023, me arsyetimin se ajo ishte e pabazuar në ligj dhe prova. Ndër të tjera, gjykata ka arsyetuar se ndaj personit nën hetim vazhdon të ekzistojë një dyshim i arsyeshëm e i mbështetur në prova në lidhje me veprën penale për të cilën ai dyshohet dhe nga verifikimi masa e sigurimit “Arresti në shtëpi” vazhdon t'i përgjigjet rëndësisë së faktit dhe rrezikshmërisë së autorit si person me rrezikshmëri të madhe, dhe se kualifikimi i veprës penale nuk ka ndryshuar. Po sipas gjykatës, masa e sigurimit “Arresti në shtëpi” vazhdon të jetë e vetmja masë e përshtatshme për kërkuesin, i cili nuk mund të ndërhyjë në marrjen e provave nga organi procedues për hetimin e kësaj çështjeje, në kushtet kur hetimet për këtë procedim nuk kanë përfunduar, përkundrazi janë zgjatur me vendim. Në arsyetimin e këtij vendimi gjykata ka mbajtur parasysh edhe vendimin unifikues nr. 7/2011.

6. Mbi ankimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. (30-2023-4123) 1109, datë 18.07.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë, me arsyetimin se nga momenti i caktimit të masës së sigurimit nuk ka një ndryshim të akuzës ose lehtësim të përgjegjësisë së personit të hetuar lidhur me këtë veprë penale. Sipas gjykatës së apelit, nevojat e sigurimit vazhdojnë të jenë të njëjta dhe masa e sigurimit “Arresti në shtëpi” vijon të mbetet e vetmja masë e përshtatshme për personin nën hetim në raport me rëndësinë e veprës dhe sanksionin penal të parashikuar për veprën penale konkrete. Po sipas saj, fakti i referuar nga kërkuesi që hetimet kanë përfunduar dhe ndaj tij është komunikuar akuza, tregon për ekzistencën e provave në ngarkim të tij dhe jo thjesht të dyshimit për kryerjen e veprës penale. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuesi.

7. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-1729, datë 31.10.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmban ndonjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432 të KPP-së. Sipas Gjykatës së Lartë nga gjykata e apelit nuk ka mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural penal me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore apo me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë të provave, dhe vendimmarrja e saj nuk vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

8. Në datën 28.02.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit. Gjithashtu, në datën 02.04.2024 kërkuesi ka paraqitur një akt me emërtimin “Memo drejtuar Gjykatës Kushtetuese”, së cilës i ka bashkëlidhur shkurtimin e vendimit nr. 692 (30-2024-2327), datë 28.03.2024 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, e cila ka ndryshuar vendimin nr. 3006, datë 15.12.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, duke e deklaruar kërkuesin të pafajshëm për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 248 dhe 320 të KP-së.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

9. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara i kanë cenuar:

- 9.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:*
- 9.1.1 *Së drejtës për t'u njoftuar për gjykimin, pasi sipas shpalljes publike të Gjykatës së Lartë të datës 02.10.2023, shqyrtimi në dhomën e këshillimit të rekursit, fillimisht, ishte planifikuar për datën 24.10.2023, por në këtë datë nuk është zhvilluar dhe është shtyrë për datën 31.10.2023, pa caktuar orën e saktë të seancës. Në vijim, rekursi është shqyrtuar në datën 31.10.2023. Sipas kërkuetit, mungesa e orarit të gjyimit dhe mosrespektimi i afatit 30-ditor të njoftimit, referuar nenit 436, pika 3, të KPP-së, kanë ndikuar drejtpërsëdrejti mbi të drejtat dhe interesat e ligjshëm të tij.*
- 9.1.2 *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe proporcionalitetit/kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë, pasi:*
- 9.1.2.1. *Vendimet e të tria gjykatave janë dhe mbeten abstrakte dhe steriotipe, sepse të tria gjykatat nuk kanë diskutuar shkaqet e posaçme për caktimin e masës së sigurimit personal “Arresti në shtëpi”, përpjesëtueshmërinë, (proporcionalitetin) dhe përshtatshmërinë në rastin konkret dhe të individualizuar.*
- 9.1.2.2. *Arsyetimet e vendimeve të tria gjykatave janë jologjike, të paqarta në formë dhe përmbajtje, ndërsa u mungon uniteti dhe lidhja e ngushtë e pjesëve përbërëse. Kjo është qartësisht e kuptueshme vetëm nga leximi, por edhe nga kuptimi i lexueshmërisë që lidhet me faktet dhe provat. Sipas kërkuetit, pretendimet e mbrojtësit dhe të tij nuk gjenden të analizuara dhe mungon uniteti mes kërkimeve dhe përfundimit të arritur nga gjykatat. Po kështu, Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje shkaqeve të rekursit dhe memos së paraqitur pranë saj, por ka dalë në tejkalim dhe shkelje të nenit 75/b/1 të KPP-së.*
- 9.1.2.3. *Gjykata e Lartë nuk ka marrë në konsideratë vendimet unifikuese nr. 7/2011 dhe nr. 3/2002, praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) dhe jurisprudencën kushtetuese, lidhur me llojet e masave të sigurimit personal, duke mos treguar pse caktimi i masës*

“Arresti në shtëpi” është më i përshtatshëm se ndonjë masë tjetër e sigurimit personal. Rasti i tij gjendet në situatë më të vështirë se çështja *Hysa kundër Shqipërisë*, dhe referuar kësaj praktike masa e sigurimit personal ndaj tij duhet të ishte revokuar menjëherë nga gjykata. Po kështu, gjykatat nuk kanë marrë në konsideratë as vendimet e Kolegjit Penale të Gjykatës së Lartë të lidhura specifikisht me përmbaruesin gjyqësor privat, si nr. 00-2022-295, datë 08.03.2022; nr. 00-2022-1468, datë 22.11.2022 dhe nr. 00-2023-27, datë 12.01.2023, ku ai nuk është hetuar nën kufizimin e asnjë mase sigurimi personal, aq më pak nën ato shtrënguese.

9.1.2.4. Gjykatat kanë anashkaluar detyrimin për zbatueshmërinë e vendimeve të kësaj Gjykate, sikurse nr. 20/2011, nr. 55/2012 dhe nr. 68/2016. Ato dështuan të tregojnë minimalisht detyrimet e lindura nga KEDNJ-ja lidhur me arsyet dhe faktet relevante dhe të mjaftueshme për të justifikuar masën e arrestit në shtëpi dhe kufizimin e pajustificuar të të drejtave dhe lirive. Ato nuk treguan kujdesin minimal lidhur me detyrimet e përmbaruesit për sa i përket sigurimit të përgjegjësisë profesionale, ndërsa për shkak të kohës të qëndrimit nën këtë masë atij i është përshkallëzuar në përkeqësim situata e operatorit ekonomik, duke mos disponuar dhe poseduar zyrën e përmbarimit privat.

9.1.3 *Së drejtës për t’u mbrojtur*, të garantuar nga neni 31 i Kushtetutës, pasi mbetet e paqartë se kur organi i akuzës e ka vënë në dijeni në mënyrë të menjëhershme dhe hollësisht për akuzën dhe të drejtat e tij. Gjykatat nuk kanë marrë në konsideratë një sërë dokumentesh që gjendeshin në dosje, të cilat duhet të analizoheshin individualisht për të arritur në përfundimin e caktimit të masës në mënyrë të përshtatshme, proporcionale, objektivist të mbështetur në fakte, prova dhe ligj dhe sipas nevojave, si dhe ngushtësisht të lidhur me procedimin penal nr. 8586/2022.

9.2. *Parimin e barazisë përpara ligjit*, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi i njëjti kolegji i Gjykatës së Lartë ka disponuar vendimin nr. 00-2023-1727 (288), datë 31.10.2023, ku dukshëm ka zbatuar një standard tjetër për aplikimin e nenit 246,

paragrafi 6, të KPP-së. Në rastin e tij, ai (kolegji) nuk ka treguar asnjë shkak dhe/ose argument se ku është bazuar për të mos konsideruar zbatimin e nenit 246, paragrafi 6, të KPP-së. Në këtë situatë, Gjykata e Lartë është treguar haptazi e anshme dhe e pamotivuar, ndërsa vendimi i saj mbetet i paargumentuar në mënyrë të qartë, duke rënduar pozitën e tij.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkesit

10. Çështja e legjitimitimit është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

11. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

12. Gjykata ka pohuar se në rastin e kufizimit të lirisë personale si pasojë e zbatimit të masave të sigurimit personal me karakter shtrëngues, kërkesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues edhe nëse në kohën e shqyrtimit të çështjes në këtë Gjykatë ai nuk ndodhet më në kushtet e kufizimit të lirisë (*shih vendimin nr. 17, datë 13.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkesi ka kundërshtuar procesin gjyqësor të zhvilluar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për kërkesën e tij për revokimin e masës së

sigurimit personal “Arresti në shtëpi”. Pas përfundimit të këtij procesi (31.10.2023), gjykata e shkallës së parë (15.12.2023) e ka deklaruar fajtor kërkuesin. Ky vendim është ndryshuar nga gjykata e apelit (28.03.2024), e cila e ka deklaruar atë të pafajshëm. Kjo do të thotë se në kohën e shqyrtimit paraprak të ankimit kushtetues individual të kërkuesit, masa e sigurimit personal “Arresti në shtëpi” nuk ka sjellë më efekte ndaj tij.

14. Kolegji duke mbajtur në konsideratë standardin e mësipërm kushtetues në raport me rrethanat e rastit konkret, vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, sepse ka interes të drejtpërdrejtë për çështjen e parashtruar, në zbatim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës.

15. Për sa i takon kriterit për *shterimin e mjeteve juridike efektive*, individi mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim individual kushtetues, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Detyrimin për përbushjen e këtij kriteri Gjykata e ka vlerësuar si në rastet e vendimeve përfundimtare, që kanë përmbysllur në themel procesin gjyqësor, ashtu edhe në rastin e vendimeve të ndërmjetme, karakteri i të cilave është konsideruar përfundimtar për qëllimet e nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës. Për sa u takon këtyre të fundit, Gjykata ka pranuar se vendimi gjyqësor për caktimin e masës të sigurimit personal me karakter shtrëngues që lidhet me heqjen e lirisë së individit, si përjashtim, e bëjnë atë vendim përfundimtar në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 17, datë 13.03.2024; nr. 19, datë 04.04.2023; nr. 28, datë 23.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Kolegji evidenton se kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta për kërkesën e tij për revokimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arresti në shtëpi”, ndaj ai i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t’i drejtohej Gjykatës.

17. Gjithashtu, Kolegji çmon se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi më i fundit gjyqësor i kundërshtuar prej tij, vendimi i Gjykatës së Lartë, është dhënë në datën 31.10.2023, ndërsa ankimi kushtetues është paraqitur në datën 28.02.2024, pra brenda afatit 4 - mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.



18. Lidhur me legjitimimin *ratione materiae*, kërkuesi ka kundërshtuar vendimet e gjykatave të zakonshme që kanë shqyrtuar kërkesën e tij për revokimin e masës së sigurimit personal “Arresti në shtëpi”, me pretendimin se gjykatat i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t’u njoftuar, standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës për t’u mbrojtur, si dhe parimin e barazisë përpara ligjit, duke sjellë për pasojë mungesën e proporcionalitetit të kufizimit të lirisë personale në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë dhe të veprimtarisë ekonomike që ai ushtron.

19. Për sa i takon pretendimit për cenimin e *së drejtës për t’u njoftuar për gjykimin*, kërkuesi ka argumentuar se sipas shpalljes publike të Gjykatës së Lartë të datës 02.10.2023, shqyrtimi në dhomën e këshillimit të rekursit, fillimisht, ishte planifikuar për datën 24.10.2023, por në këtë datë nuk është zhvilluar dhe është shtyrë për datën 31.10.2023, pa caktuar orën e saktë të seancës. Sipas kërkuesit, rekursi është shqyrtuar në datën 31.10.2023 dhe mungesa e orarit të gjykimit dhe mosrespektimi i afatit 30-ditor të njoftimit, referuar nenit 436, pika 3, të KPP-së, kanë ndikuar drejtpërsëdrejti mbi të drejtat dhe interesat e ligjshëm të tij.

20. Kolegji vëren se në rastin në shqyrtim Gjykata e Lartë ka vendosur në dhomën e këshillimit mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsytimin se ai nuk përmban ndonjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432 të KPP-së. Kjo do të thotë se Gjykata e Lartë i ka dhënë fund shqyrtimit të rekursit që në fazën seleksionuese, pasi ka analizuar kushtet e pranueshmërisë në dhomën e këshillimit, ku në mungesë të ekzistencës së tyre ka disponuar për mospranimin e tij. Në kundërt, nëse Gjykata e Lartë do të vlerësonte se rekursi plotësonte kushtet e pranueshmërisë, çështja do të shqyrtohej në seancë gjyqësore, për të cilin neni 436, pika 3, i KPP-së parashikon njoftimin e palëve për ditën dhe orën e gjykimit të paktën 30 ditë përpara. Thënë kjo, Kolegji vlerëson se afati ligjor 30-ditor i parashikuar nga neni 436, pika 3, i KPP-së nuk gjen zbatim në rastin e kërkuesit, ndaj pretendimi i tij për cenimin e *së drejtës për t’u njoftuar për gjykimin* nuk mund të merret në shqyrtim.

21. Gjithashtu, kërkuesi ka pretenduar *cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor* nga Gjykata e Lartë, ndër të tjera, edhe me argumentin se ajo gjykatë nuk ka marrë në konsideratë faktin që rasti i tij gjendet në një situatë më të rëndë se çështja *Hysa kundër Shqipërisë* dhe as me praktikën e vetë asaj gjykate referuar vendimeve të lidhura specifikisht me përmbarues gjyqësor privatë, ku në ato raste personi nuk është hetuar nën asnjë masë sigurimi personal, aq më

pak nën ato shtrënguese, si “Arresti në burg” e me tej “Arresti në shtëpi”. Po kështu, lidhur me cenimin e *së drejtës për t’u mbrojtur*, kërkuesi ka argumentuar se gjykatat nuk kanë marrë në konsideratë një sërë dokumentesh që gjendeshin në dosje, të cilat duhet të analizoheshin individualisht për të arritur në përfundimin e caktimit të masës në mënyrë të përshtatshme, proporcionale, objektivist të mbështetur në fakte, prova dhe ligj dhe sipas nevojave dhe ngushtësisht të lidhur me procedimin penal nr. 8586/2022. Gjithashtu, sipas kërkuesit, Gjykata e Lartë ka cenuar edhe *parimin e barazisë përpara ligjit*, pasi i njëjti kolegji penal ka disponuar vendimin nr. 00-2023-1727 (288), datë 31.10.2023, ku dukshëm ka zbatuar një standard tjetër për aplikimin e nenit 246, paragrafi 6, të KPP-së, ndërsa në rastin e tij ky standard pa asnjë shkak dhe/ose argument nuk është marrë në konsideratë. Sipas kërkuesit, Gjykata e Lartë është treguar haptazi e anshme, e pamotivuar dhe ka dhënë vendim të paargumentuar në mënyrë të qartë, duke rënduar pozitën e tij.

22. Kolegji, në analizë të këtyre argumenteve, vëren se ato janë më tepër të natyrës ligjore dhe lidhen me interpretimin dhe zbatimin e ligjit nga gjykatat e zakonshme, si dhe me vlerësimin e provave në drejtim të përcaktimit nëse kërkimi i kërkuesit për revokimin e masës së sigurimit personal ishte apo jo i bazuar. Po kështu, Kolegji vë në dukje se mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, sepse çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, në varësi të rrethanave dhe faktorëve të cilët nuk mund të jenë të njëjtë. Në rastin konkret, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë qenë në të njëjtën qasje lidhur me vlerësimin e fakteve dhe provave të administruara dhe të shqyrtuara deri në ato momente, si dhe me interpretimin dhe zbatimin e ligjit. Nga ana tjetër, vendimet e referuara nga kërkuesi përmbajnë rrethana dhe palë të ndryshme, të cilat kanë specifikat e tyre, që do të thotë se mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit vlerësohet nga gjykatat në kontekst të fakteve dhe provave të çështjes konkrete. Për më tepër, argumentet e kërkuesit, në thelb, kanë të bëjë me mënyrën e zbatimit të ligjit, që, si rregull, është atribut i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe del jashtë juridiksionit kushtetues, ndaj ato nuk mund të merren në shqyrtim.

23. Nga ana tjetër, argumentet për proporcionalitetin e kufizimit të lirisë personale dhe të veprimtarisë së operatorit ekonomik, kërkuesi i ka ngritur të lidhura me procesin gjyqësor të zhvilluar ndaj tij, për rrjedhojë Kolegji çmon t’i analizojë ato në këndvështrim të nenit 42 të

Kushtetutës, sipas të cilit të drejtat kushtetuese nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e tyre, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë.

24. Për sa më lart, Kolegji do të shqyrtojë pretendimet e kërkuarit në drejtim të cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor që *prima facie* hyn në juridiksionin kushtetues.

*B. Për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor.*

25. Kërkuari ka pretenduar se vendimet e të tria gjykatave janë dhe mbeten abstrakte dhe steriotipe, sepse gjykatat nuk kanë diskutuar shkaqet e posaçme për caktimin e masës së sigurimit personal “Arresti në shtëpi”, përpjesëtueshmërinë (proporcionalitetin) dhe përshtatshmërinë e saj në rastin konkret. si dhe individualizimin. Arsyetimet e vendimeve të të tria gjykatave janë jologjike, të paqarta në formë dhe përmbajtje, ndërsa u mungon uniteti, ngushtësia e pjesëve përbërëse, qartësia e kuptueshme vetëm nga leximi, por edhe nga kuptimi i lexueshmërisë që lidhet me faktet dhe provat. Sipas kërkuarit, pretendimet e mbrojtësit dhe të tij nuk gjenden të analizuara dhe mungon uniteti mes kërkimeve të tij dhe përfundimit të arritur nga gjykatat. Sipas tij, mbetet e paqartë se kur organi i akuzës e ka vënë në dijeni atë në mënyrë të menjëhershme dhe hollësisht për akuzën dhe të drejtat e tij. Ndërsa, Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje shkaqeve të rekursit dhe memos së paraqitur pranë saj, por ka dalë në tejkalim dhe shkelje të nenit 75/b/1 të KPP-së. Gjykata e Lartë nuk ka marrë në konsideratë vendimet unifikuese nr. 7/2011 dhe nr. 3/2002, praktikën e GJEDNJ-së dhe jurisprudencën kushtetuese, lidhur me llojet e masave të sigurimit personal, duke mos treguar pse caktimi i masës “Arresti në shtëpi” është më i përshtatshëm se ndonjë masë tjetër e sigurimit personal. Po kështu, kërkuari ka argumentuar se gjykatat kanë anashkaluar detyrimin për zbatueshmërinë e vendimeve të kësaj Gjykate, sikurse nr. 20/2011, nr. 55/2012, nr. 68/2016. Ato dështuan të tregojnë minimalisht detyrimet e lindura nga KEDNJ-ja lidhur me arsyet dhe faktet relevante dhe të mjaftueshme për të justifikuar masën e arrestit në shtëpi dhe kufizimin e pajustificuar të të drejtave dhe lirive, si dhe nuk treguan kujdesin minimal lidhur me detyrimet e përmbartësve për sa i përket sigurimit të përgjegjësive profesionale, ndërsa për shkak të kohës të qëndrimit nën këtë masë atij i është përshkallëzuar në përkeqësim situata e operatorit ekonomik duke mos disponuar dhe poseduar zyrën e përmbartimit privat.

26. Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga neni 42 i Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsytuar, cili

përkon edhe me detyrimin e gjykatave për të arsyetuar vendimet, sipas nenit 142, pika 1, të Kushtetutës. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje dhe në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 42, datë 25.05.2017; nr. 25, datë 10.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Po kështu, Gjykata e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Ndërsa në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 10, datë 04.03.2021; nr.18, datë 15.03.2016; nr. 8, datë 28.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Kolegji vëren se procesi gjyqësor është vënë në lëvizje me kërkesën e kërkuarit për revokimin e masës së sigurimit personal “Arresti në shtëpi”, me pretendimin se në fazën e caktimit të masës së sigurimit dhe verifikimit të kushteve (marrjen në pyetje), gjyqtarja dhe prokurori kanë kryer shkelje procedurale, si dhe kanë analizuar edhe elementet e figurës së veprës penale për të cilën dyshohet.

29. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin e datës 29.06.2023, ka rrëzuar kërkesën e kërkuarit, duke arsyetuar, ndër të tjera, se kërkuari nuk ka paraqitur asnjë fakt dhe provë në mbështetje të kërkesës. Sipas gjykatës, ndaj personit nën hetim vazhdon të ekzistojë një dyshim i arsyeshëm e i mbështetur në prova në lidhje me veprën penale për të cilën ai dyshohet dhe nga verifikimi i provave dhe i rrethanave të faktit masa e sigurimit “Arrest në shtëpi” vazhdon t'i përgjigjet rëndësisë së faktit dhe rrezikshmërisë së autorit si person me rrezikshmëri të madhe. Masa dhe lloji i dënimit për veprat penale për të cilën dyshohet personi nën hetim janë elemente që merren në shqyrtim nga gjykata edhe në momentin e zëvendësimit të

masës së sigurimit. Sipas gjykatës, vepra penale për të cilën dyshohet kërkuesi paraqet rrezikshmëri shoqërore dhe vetë ai paraqet rrezikshmëri të madhe, për më tepër që deri në ato momente nuk ka ndryshuar kualifikimi i veprës penale. Në këto rrethana, shprehet gjykata e shkallës së parë, masa e sigurimit e caktuar ndaj kërkuesit vazhdon të jetë e vetmja masë e përshtatshme dhe ai nën këtë masë nuk mund të ndërhyjë në marrjen e provave nga organi procedues për hetimin e çështjes, në kushtet kur hetimet për këtë procedim nuk kanë përfunduar, përkundrazi janë zgjatur. Gjithashtu, gjykata është shprehur se ajo ka mbajtur parasysh edhe vendimin unifikues nr. 7/2011.

30. Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin e datës 18.07.2023, ka konfirmuar vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë, duke e lënë në fuqi atë. Ajo gjykatë ka arsyetuar se në zbatim të nenit 260, pikat 1 e 2, të KPP-së dhe shkaqeve për të cilat është kërkuar revokimi i masës së sigurimit, asnjë prej tyre nuk vërteton as mungesën e kushteve dhe kriterëve të zbatimit të masës së caktuar, as zbutjen e nevojave të sigurimit apo rrethanave që e cilësojnë faktin penal për të cilin hetohet si më të lehtë. Sipas gjykatës së apelit, pretendimet e kërkuesit nuk janë të tilla sa të përlligjin kërkesën për zëvendësimin e masës së sigurimit “Arresti në shtëpi”, pasi nga momenti i caktimit të saj nuk ka një ndryshim të akuzës ose lehtësim të përgjegjësisë së tij. Po kështu, sipas gjykatës së apelit, pretendimi që kërkuesi nuk paraqet rrezikshmëri të veçantë është marrë parasysh në caktimin e masës së sigurimit “Arrest në shtëpi”. Ndërsa, fakti i referuar prej tij se hetimet kanë përfunduar dhe ndaj tij është komunikuar akuza, tregon për ekzistencën e provave në ngarkim të tij dhe jo thjesht të dyshimit për kryerjen e veprës penale.

31. Në vijim, Gjykata e Lartë, në vendimin e datës 31.10.2023, nëpërmjet të cilit ka vendosur pranimin e rekursit, ka argumentuar se pretendimet e parashtruara në të, që lidhen me zbatimin e nenit 260/2 të KPP-së, janë vlerësuar nga gjykatat e faktit në raport me ekzistencën e nevojave të sigurimit, me kushtet e kriteret që janë marrë në konsideratë në caktimin e masës së sigurimit në këtë rast, duke u analizuar ky kërkim edhe në raport me rrethanat e faktit dhe provat e paraqitura nga kërkuesi dhe prokurori. Po kështu, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se gjykatat e faktit në vendimmarrjen e tyre iu kanë dhënë përgjigje të argumentuar pretendimeve të kërkuesit për shkelje të ligjit procedural penal, të lidhur me ekzistencën e nevojave të sigurimit, sipas kriterëve të përcaktuara në nenet 229, 230 dhe 237 të KPP-së.

32. Gjithashtu, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se gjykata e apelit i ka dhënë përgjigje të argumentuar pretendimeve të kërkuesit për plotësimin e kriterëve të ligjit procedural penal, nenit 260 të KPP-së. Ajo ka vënë në dukje se arsyetimi i gjykatës së apelit nuk përbën paragjykim apo njëanshmëri të saj, por lidhet me vlerësimin e faktit se nevojat fillestare të sigurimit që diktuan vendosjen e kësaj mase vijnë të ekzistojnë. Gjithashtu, edhe për sa i takon pretendimit për arsytetime “steriotip” nga gjykatat e faktit, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se kërkuesi në shkaqet e parashtruara në rekurs nuk ka evidentuar dhe analizuar ndonjë rrethanë konkrete të mbështetur në prova që nuk është vlerësuar e drejtë nga gjykatat e faktit dhe që të përbëjë shkak për revokim/zëvendësim të masës së sigurimit personal. Gjithashtu, sipas saj, praktikat gjyqësore të evidentuara në rekurs nuk analizohen në raport me rastin konkret dhe rrethanat konkrete që ekzistojnë për kërkuesin, i cili akuzohet për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 248 i KP-së, me pasoja të rënda. Ndërsa për sa u takon pretendimeve në rekurs që ngrenë çështje të vlerësimit të provave (të shqyrtuara nga gjykatat e faktit, mbi të cilat është vendosur mospranimi i kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit), Gjykata e Lartë ka argumentuar se ato dalin jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të saj.

33. Në analizë të përmbajtjes së vendimeve gjyqësore objekt kundërshtimi, Kolegji konstaton se ato paraqiten të rregullta në formë dhe pasqyrojnë rrethanat e çështjes, shkaqet e përmbledhura të kërkesës së kërkuesit në shkallë të parë dhe ato të ankimit/rekursit në dy shkallët e tjera, duke treguar, këto të fundit, në pjesën arsyetuese edhe arsyet e mospranimit të ankimit/rekursit. Vendimet nuk rezultojnë alogjike, kontradiktore ose të paqarta në përmbajtje. Në pjesën arsyetuese ato i japin përgjigje kërkimit të kërkuesit për revokimin e masës së sigurimit personal, pasi kanë marrë në shqyrtim, analizuar dhe vlerësuar në mënyrë të argumentuar pretendimet e tij të ngritura në ankim dhe rekurs. Po kështu, duket se pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe në unitet e harmoni me njëra-tjetrën, duke përjashtuar çdo kundërthënie, kontradikcion të hapur ose të fshehtë. Nga ana tjetër, ndonëse Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, arsyetimi i saj nuk duket të jetë i kufizuar, pasi u ka dhënë përgjigje në thelb shkaqeve të parashtruara në rekurs. Në këtë mënyrë, vendimet gjyqësore plotësojnë standardet kushtetuese të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

34. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar. Rrjedhimisht edhe argumentet në drejtim të kufizimit të lirisë personale dhe veprimtarisë ekonomike nuk qëndrojnë.

35. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31, dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.